



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendos: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Bart

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 16 nëntor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Mocionin e Rregullës 130

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Valeria Boliçi

Methju Haling

Xhejms Pejs

Mbrojtjes së Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

Eleanor Stivenson

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

Xhonatan Pitër Uorbojs

TRUPI GJYKUES II ("Paneli"), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 116 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 nëntor 2021, Mbrojtja e Nasim Haradinajt ("Mbrojtja e Haradinajt") dhe Mbrojtja e Hysni Gucatit ("Mbrojtja e Gucatit") konfirmuan synimin e tyre për të dorëzuar një mocion për rrëzimin e akuzave në bazë të nenit 130 të Rregullores (përkatësisht "Mocioni i Haradinajt" dhe "Mocioni i Gucatit", së bashku "Mocionet").¹
2. Më 9 nëntor 2021, Paneli e urdhëroi Mbrojtjen që Mocionet t'i dorëzojë deri më 17 nëntor 2021 dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), që të përgjigjej ndaj Mocioneve deri më 24 nëntor 2021 ("Përgjigja Përmbledhëse e ZPS-së").²
3. Më 15 nëntor 2021, Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi një kërkesë për ta çuar numrin e lejuar të fjalëve për Mocionin e Haradinajt nga 6.000 në 9.000 fjalë ("Kërkesa").³

II. PARASHTRIMET

4. Mbrojtja e Haradinajt parashtron se në favor të miratimit të Kërkesës janë faktorët e mëposhtëm: (i) sasia e provave që duhet të shqyrtojë Paneli për vlerësimin e Mocionit; (ii) Mocioni do të kërkojë që të hidhen poshtë të gjashtë akuzat që përmban Aktakuza; (iii) Kërkesa e bërë në kohën e duhur nuk dëmton ZPS-në; (iv) është në

¹ Transkript, 8 nëntor 2021, faqet 2032, 2036.

² F00428, Panel, Urdhër për Planin e Punës dhe Caktimin e Afateve për Hapat e Tjerë të Proce (ky është titull që ekziston, prandaj e ktheva në këtë formë), 9 nëntor 2021, para. 16 (b) dhe (c).

³ F00434, Mbrojtja e Haradinajt, Kërkesë e Mbrojtjes për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Parashtrimin sipas Rregullës 130 ("Kërkesa"), 15 nëntor 2021.

interes të drejtësisë që Mbrojtja të mund ta argumentojë Mocionin në mënyrë të plotë; dhe (v) numri i fjalëve që kërkohet të shtohen është minimal.⁴

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Sipas nenit 41 të Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative – mbi Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”),⁵ mocionet nuk duhet të tejkalojnë 6.000 fjalë.

6. Sipas nenit 36 të Udhëzuesit të Punës, në rrethana të veçanta dhe në kohë të mjaftueshme, palët mund të kërkojnë miratimin e Panelit që ta tejkalojnë numrin e lejuar të fjalëve dhe të shpjegojnë arsyet e vlefshme që justifikojnë këtë tejkallim që kërkohet. Në rastet kur nuk dëmtohet pala kundërshtare, Paneli mund të trajtojë mocionet që kërkojnë shtimin e numrit të fjalëve pa i dhënë palës kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin e vet.

IV. DISKUTIM

7. Paneli vëren se me anë të Mocionit të saj, Mbrojtja e Haradinajt synon të kundërshtojë të gjashtë akuzat që përmban Aktakuza.⁶ Paneli gjykon se është në interes të drejtësisë që Mbrojtja e Haradinajt të mund t’i argumentojë kundërshtimet e saj në mënyrë të plotë e të përshtatshme. Në këtë aspekt, Paneli është i bindur se ekzistojnë arsye të vlefshme për të miratuar 3.000 fjalët shtesë që kërkon Mbrojtja e Haradinajt.

⁴ Kërkesa, paragrafët 4-5.

⁵ KSC-BD-15, Zyra Administrative, *Udhëzues Pune i Zyrës Administrative mbi Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës*, 17 maj 2019.

⁶ Transkript, 8 nëntor 2021, f. 2036.

8. Me qëllim që të ruhet barazia a palëve, Paneli po kështu e shton, *proprio motu*, numrin e fjalëve për Mocionin e Gucatit dhe për Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së ndaj dy Mocioneve të Mbrojtjes.

9. Duke marrë parasysh sa më sipër, Paneli gjykon se Kërkesa nuk dëmton ZPS-në. Për këtë arsye, Paneli merr vendimin mbi Kërkesën pa pritur përgjigjen e ZPS-së me qëllim që të përshpejtohet procesi.

10. Megjithatë, Paneli shfrytëzon rastin t'i udhëzojë palët që në parashtrimet e tyre përkatëse të përqendrohen në aspekte juridike dhe faktike të cilat do të shqyrtohen nga Paneli dhe të mos citojnë fjalë për fjalë dispozita përkatëse dhe të mos bëjnë paraqitje të gjerësishme të standardeve juridike përkatëse.

V. VENDIM

11. Për këto arsye, Paneli:

- (i) **MIRATON** Kërkesën; dhe
- (ii) **SHTON** numrin e lejuar të fjalëve për:
 - a. Mocionin e Haradinajt deri në 9.000 fjalë;
 - b. Mocionin e Gucatit deri në 9.000 fjalë;
 - c. Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së deri në 9.000 fjalë.

/nënshkrim/

Gjykatës Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E martë, 16 nëntor 2021

Hagë, Holandë